



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2024

VENDIM

Nr. 141, datë 13.03.2024

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE
TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU
USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} etj ; Akuza: Nenet 283/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Luljeta Kole (Trebicka) (relatore), gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Rexhep Bektashi si dhe gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Edvan Veçani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 284/1, 283/1, 333/a/1 dhe 334 të Kodit Penal (dosje e ndarë nga dosja me të pandehur {...})

3. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Paulin Çera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 80, 278/1, 28/4, 186, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal (në seancë paraprake).

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR